



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORI

URDHËR

Nr.21, date 20.02.2017

“PËR FILLIMIN E PROCESIT TË ZGJEDHJEVE JASHTË RRADHE DHE DATËN E ZHVILLIMIT TË TYRE PËR DISA AUTORITETE DREJTUESE NË UNIVERSITETIN “ALEKSANDËR XHUVANI” ELBASAN”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 5/ 3 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë” nr.1459/1prot., datë 15.03.2016, si dhe në zbatim të Urdhrit të Ministrit Arsimit dhe Sportit nr.78 datë 16.02.2017 “Për fillimin e procesit të zgjedhjeve jashtë rradhe dhe datën e zhvillimit të tyre për disa autoritete drejtuese në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan”,

Urdhëroj:

1. Fillimin e procesit të zgjedhjeve jashtë rradhe dhe datën e zhvillimit të tyre për disa autoritete drejtuese në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan”, si më poshtë:
 - a. Dekan i Fakultetit në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike;
 - b. Përgjegjës i departamentit të Infermieristikës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike;
 - c. Përgjegjës i departamentit të Financë-Kontabilitetit në Fakultetin Ekonomik.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet e mësipërme drejtuese të jetë më data **20.03.2017**.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.Dr. Skender TOPI